



## Njoftim për METD

### Konventa në mes Kosovës dhe Letonisë

*Njoftim lidhur me përmbajtjen e Marrëveshjes për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë ( METD) për tatimet në të ardhura dhe parandalimit të shmangies së tatimit, në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Letonisë.*

Administrata Tatimore e Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të METD-së, ku në kuadër të kësaj ofron edhe shërbime për tatimpaguesit të cilët mbulohen nga këto marrëveshje.

Për zbatimin e kësaj METD, personat që do të kenë të drejtë të qasjes në të duhet të jenë rezident të njërit prej apo të të dy shteteve kontraktuese. Marrëveshja zbatohet ndaj tatimeve direkte : Tatimi në të Ardhura të Korporatave dhe Tatimit në të ardhura Personale, METD poashtu aplikohet për çdo tatim identik, të ngjashëm apo në thelb të ngjashëm, të cilat caktohen pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes, përveq apo në vend të tatimeve ekzistuese.

Sipas kësaj marrëveshje për të krijuar “Seli të Përhershme” duhet të plotësohet kriteri i një vendi fiks të punës përmes së cilës puna e një ndërmarrje zhvillohet plotësisht apo pjesërisht. Poashtu për të krijuar Seli të Përhershme duhet të plotësohet kriteri që një projekt apo aktivitet të zgjatë më shumë se nëntë muaj brenda periudhës 1 vjeqare.

Sa i përket fitimeve nga biznesi sipas marrëveshjes ato do të taten në vendin ku është kryer shërbimi, përveq nëse ndërmarrja e drejton biznesin në shtetin tjetër kontraktues përmes një selie të përhershme të vendosur aty.

Dividentat sipas marrëveshjes do të taten në vendin ku krijohen, por duke duke iu përmbajtur edhe parimit të pronarit përfitues të dividentës.

Sipas kësaj marrëveshje, Kamata që lind në shtetin kontraktues dhe që i paguhet rezidentit të Shtetit tjetër kontraktues, mund të taten në shtetin tjetër. Megjithatë kamata gjithashtu mund të taten në shtetin kontraktues ku lind por nëse pronari përfitues i kamatës është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk do të tejkaloj 10% të shumës bruto të kamatës.

Lidhur me Tantiemat që paraqiten në shtetin kontraktues dhe që i paguhet rezidentit të shtetit tjetër kontraktues, mund të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet tjetër. Sidoqoftë, tantiemat e tilla mund të taten po ashtu në Shtetin Kontraktues në të cilin lindin, por nëse përfituesi i tantiemave është rezident i shtetit tjetër kontraktues, vlera e tatueshme nuk duhet të kalojë 5% të shumës bruto të tantiemës.

Sa i përket të ardhurave nga punësimi, në bazë të marrëveshjes ato do të taten në vendin e realizimit të të ardhurave. Në këtë mënyrë do të trajtohen edhe të ardhurat e realizuara nga Artistët dhe Sportistët.

Pensionet në këtë METD do të taten vetëm në shtetin e rezidencës së pranuesit.

Sa i përket eliminimit të tatimit të dyfishtë kjo do të ndodhë kur një rezident i Letonisë krijon të ardhura të cilat në përputhje me këtë METD mund të taten në Kosovë, Letonia do të lejojë si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabart me tatimin e të ardhurave që mund të paguar në Kosovë. E njëjta vlen edhe për eliminimin e tatimit të dyfishtë në Kosovë.

Lidhur me Shkëmbimin e Informacionit mes shteteve kontraktuese kjo bëhet me kërkesën e autoritetit tatimor për tatimpaguesit.